Kronikë

VIDEO/ U kap me pushkë dhe municion luftarak, pranga 18-vjeçarit në Sarandë! Dyshohet se do i shiste

Një 18-vjeçar është arrestuar në Sarandë, pasi është kapur duke lëvizur me një pushkë me vete. 18-vjeçari dyshohet se do ta shiste.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
20 Shkurt, 09:13 | **Përditesimi: 20 Shkurt, 09:28**

Share

SARANDË- Një 18-vjeçar është arrestuar në Sarandë, teksa ka qenë duke lëvizur me motor, ndërsa ka pasur me vete një pushkë dhe municion luftarak.

Dyshohet se 18-vjeçari Ledion Vaja do ta shiste në qytetin e Sarandës pushkën dhe municionin luftarak. Në pamje shihet edhe momenti arrestimit të adoleshentit, ndërsa në kokë mban skafandrën e motorit.

> *"Gjatë kontrollit fizik ndaj 18-vjeçarit, i cili në momentin e ndalimit nga Policia udhëtonte me një motomjet, shërbimet e Policisë i gjetën 1 armë zjarri pushkë, krehër dhe municion luftarak, të cilat dyshohet se ky shtetas do t'i shiste në qytetin e Sarandës", njofton policia.*

LEXO EDHE:
VIDEO /Hidhnin mbeturina në 'Qafën e Llogarasë' dhe ndotnin mjedisin, nis hetimi për 3 administratorë restorantesh

Ndërkohë, policia ka arrestuar një 20-vjeçar, Orhan Xhango, dhe ka vënë në hetim një 17-vjeçar, pasi dyshohet se kishin dijeni për këtë rast.

Arma e zjarrit pushkë, municioni luftarak dhe motomjeti që drejtonte 18-vjeçari, në momentin e kapjes në flagrancë nga Policia, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Vlore sarande

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A duhet politika të bashkohet e miratojë amnistinë penale?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Planifikuan atentatin ndaj Inez Hajrullës, GJKKO lë në burg Muharem Koroveshin
19 Shkurt, 14:52

Sarandë/ Pjesë e grupit të montimit të minave me telekomandë, arrestohet 26-vjeçari! Një ditë më parë u sekuestruan 5 kallëpe tritoli
19 Shkurt, 14:37

Flamurtari në kundërsulm ndaj FSHF-së, denoncon delegatin Bujar Pregja në policinë e Vlorës: Nxit dhunën
18 Shkurt, 17:30

Sekuestrohen 5 kallëpe tritol në Sarandë, 2 të montuara me telekomandë, arrestohen 2 vëllezër! Në kërkim një 26 vjeçar (EMRAT+VIDEO)
18 Shkurt, 14:00

Shkrumbohet nga flakët makina në Vlorë, ja çfarë raportohet (VIDEO)
18 Shkurt, 10:01

Nga Gjermania, SHBA e Italia, djemtë emigrantë bëhen bashkë për të bërë rrugën në Vranisht
17 Shkurt, 17:15

Planifikuan vrasjen e Inez Hajrullës, goditet 'trekëndëshi' kriminal në Vlorë, arrestohet 35-vjeçari me tre identitete, në kërkim dy të tjerë (Emri)
17 Shkurt, 15:15

Vlorë/ Në kërkim për vjedhje, arrestohet 20-vjeçari! VIDEO nga momenti kur thyen derën e lokalit
17 Shkurt, 10:20

Auron Tare ngre alarmin: Çekiçët po gërmojnë pranë Sinagogës së shekullit të V-të në Sarandë! Në '97-ën Nano rrafshoi kioskat për ta mbrojtur
16 Shkurt, 20:40

Vlorë, shkrumbohet nga flakët fuoristrada teksa tërhiqte 'skafin' në rrugën e fshatit Kuç
16 Shkurt, 18:26

Gangrena e plehrave në Vlorë, në prill hapet landfilli i ri për depozitimin e mbetjeve urbane

Armand Xhelili

16 Shkurt, 16:03

Vlorë/ Përfshihen nga flakët kodrat në fshatin Kërkovë, banorët digjnin barishte dhe u doli nga kontrolli (VIDEO)
16 Shkurt, 13:02

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje